



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

**MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE
TË PËRZGJEDHURA TË DISA INSTITUCIONEVE PUBLIKE
NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, PËRFSHIRË
DHE PROJEKTMARRËVESHJEN E MIRËKUPTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 496 e 514 e në vijim, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e strategjisë për shlyerjen e detyrimeve të përzgjedhura të disa institucioneve publike në sektorin e energjisë elektrike dhe projekt marrëveshjes së mirëkuptimit “Për shuarjen me kompensim të detyrimeve të prapambetura të disa institucioneve publike në sektorin e energjisë elektrike”, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA